



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivory	14. 01 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	143/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.390/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 390/2020 të datës 04.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga „ Uran Ajeti ”, Mati 1, Komuna e Prishtinës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovë/Kryeministrit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës/mos vazhdim i kontratës së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.390/2020 e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Nazmi Zenelaj më datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2945/2020 të regjistruar me numër A.nr.390/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me mos vazhdimin e mandatit si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 08.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë. Këshilli më datë 18.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 390/2020, e datës 04.12.2020, me numër protokollit 2945/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesën e datës 12.05.2020, drejtuar Zyrës së Kryeministrit; Vendimi i datës 19.02.2020, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Njoftimi i datës 05.10.2020; Njoftimi i datës 28.08.2020; e- maili i datës 05.08.2020; Vendimi i datës 21.07.2020, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 19.02.2020, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; e- maili i datës 23.03.2020; Përgjigje në ankesën e datës 18.12.2020, me numër protokollit 32011, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pa lejuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.10/18 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 08.06.2011 është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me mandat tre (3) vjeçar. Përmes Vendimit Nr.08/194 të datës 23.07.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesit i është vazhduar mandati për tre (3) vite si Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa me Vendimin Nr.06/150 të datës 17.07.2017, ankuesit i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite tjera përkatësisht deri më datë 17.07.2020. Emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me vendimin 03/03/2020 të datës 19.02.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ankuesi në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ka kaluar në listën tepricë, për arsye të riorganizimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Nga shkresat e dërguara nga palët, Kolegji gjen se ankuesi së bashku me Sekretaret tjerë të Përgjithshëm të listës tepricë, i janë drejtuar me datë 14.04.2020 dhe 12.05.2020 Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Këshillit për Pozita të Larta Drejtuese, me kërkesën që të ri caktohen në pozita të njëjta ose ekuivalente brenda institucioneve të Republikës së Kosovës. Ndërsa me datë 20.08.2020 ankuesi i është drejtuar më kërkesë Kryeministrit për vazhdimin e mandatit dhe ri sistemimin në pozitë të nivelit drejtues.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Kryeministri ka vepruar në kundërshtim me normat kushtetuese dhe ligjore duke mos u përgjigjur fare në shkresat e Sekretareve të Përgjithshme tepricë dhe në heshtje ka tejkaluar obligimin e tij ligjor. Kërkon nga Këshilli që të obligoj Ministrinë e Punëve të Brendshme që të bëjë vlerësimin e performancës dhe të propozohet për Qeveri kërkesë për ri zgjatjen e mandatit sipas nenit 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -

031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht në kërkesën e ankuesit të datës 20.08.2020 drejtuar Kryeministrit të Kosovës për ri zgjatjen e mandatit, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 04.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.390/2020

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Zyrës së Kryeministrit të Republikë së Kosovës
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së.

